

PROBLEME AKTUALE TË SHQIPES SOT

Shqipja vijon të jetë nën tryshninë e shkruesve dhe folësve të pakujdesshëm. Shteti dhe institucionet publike që varen ose lejohen prej tij, duhet të kenë më shumë dashuri e kujdes për gjuhën që përdorin. Ka ardhur koha që normëshkelësit të përgjigjen për dëmin që i shkaktojnë gjuhës shqipe. "Malli" për fjalët e huaja të panevojshme është bërë ndër ne si një sëmundje ngjitëse që po merr përmasat e një epidemie gjuhëvrasëse. Kritikat e gjuhëtarëve dhe të dashamirëve të shqipes sikur bien në veshë të shurdhët. Deri edhe në librat mësimorë të shkollës së lartë përvoldhen gabime trashanike. Kjo duhet të marrë fund, përndryshe gjuha do të pësojë dëmtime të pandreqshme.

Për shqetësimet e shënuara dhe të tjera të tilla, prej shumë vjetësh, herë në artikuj për shtypin, herë në biseda për mediat e folura, si dhe në kumtesa e botime shkencore, po edhe në disa prej librave të mi ("Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur", SHBLU, Tiranë, 1996; "Kultura e gjuhës", SHBLU, 2006), nuk kam mënuar të kritikoj e të kërkoj që, më në fund, ashtu si moti i mirë pas kohës së keqe, duhet të vijë edhe në kulturën shqiptare një çast kthjellimi e sqarimi, duke marrë masat e nevojshme në plan të gjerë kombëtar për ta mbrojtur dhe përkujdesur me gjithë përkushtimin e nevojshëm qytetar e zyrtar gjuhën shqipe, këtë mjet të përbashkët e të pavdirë të njëjtësisë shpirtërore, kulturore dhe etnike të kombit tonë. Për këtë arsye, u kërkoj ndjesë lexuesve të nderuar të revistës "Univers", nëse do të ritheksoj edhe ndonjë gjë që nuk është krejt e re, ndonjë fakt a shembull që e kemi përmendur edhe më parë, porse kjo vjen edhe nga shkaku se gjendja është e atillë që ende nuk kemi parë ato ndryshime e përmirësime që pritëshin. Ka qenë punë me mend, ndonëse edhe mjaft e vonuar, rikthimi i lëndës së gjuhës shqipe në programet e shkollave të mesme, prandaj edhe e

kemi përshëndetur atë, porse vetëm ajo nuk mjafton. Pa humbur kohë, duhen ndërmarrë masa shtrënguese për zbatimin e normave të gjuhës shqipe të njësuar nga e gjithë shoqëria shqiptare dhe nga organizmat shtetërorë e institucionalë që janë zyrtarisht përgjegjës për kulturën e gjuhës, si pjesa themelore e kulturës së një kombi të qytetëruar që mëtojmë e dëshirojmë të jemi. Le të ndalemi në disa pika më kryesore ku mendojmë.

1. Kujdes më të madh për shqipen e shkruar, për botimet me karakter zyrtar e publik. Dikur thuhej me të drejtë shprehja latine “*Verba volant, scripta manent*”, çka përligjte atë përkujdesje shumë më të madhe që i takonte më parë gjuhës së shkruar, në krahasim me të folurën. Kjo thënie urtake e latinëve të mençur mbetet me vlerë edhe për kohën tonë, porse ajo edhe duhet plotësuar me kundrimin se në kohët e reja, sidomos qëkur kanë ardhur në “pushtet” mediat pamore-dëgjimore (radioja dhe televizioni, magnetofoni, videokaseta, disqet e incizuara etj.), duhet të themi se edhe fjala e folur “nuk fluturon”, por mbetet e fiksohet njësoj, madje edhe më shpejt sesa fjala e shkruar. Sot, bariu i Korabit dhe bujku i Konispolit marrin në kohë reale dhe me të njëjtën formë gjuhësore të njëjtin informacion si Presidenti i Republikës së Shqipërisë në Tiranë, si presidenti i Kosovës në Prishtinë, si të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen, në mbarë hapësirat që përçohen nga valët e drejtpërdrejta ose satelitore të radiove e të televizioneve shqiptare. Po japim vetëm një shembull domethënës e që mendojmë se vlen si përfaqësues për shumë të tillë: suedezi i famshëm Ul Maruik, tashmë i mirënjohur si përkthyes nga shqipja në suedisht, autor i shumë artikujve për Shqipërinë e shqiptarët si dhe i një Antologjie të letërsisë shqiptare për mjedisin suedez, e ka mësuar shqipen shumë vjet më parë duke dëgjuar Radio-Kukësin. (Ashtu siç e kanë mësuar italishten shumë shqiptarë, duke dëgjuar programet e RAI-t). Këtë fakt kam pasur parasysh kur kam pohuar (dhe këtij pohimi i mbahem edhe më tej) se folësit më të mirë të radios e të televizionit shqiptar kanë qenë e mbeten jo vetëm gazetarë, por edhe mësues të shqipes, modeldhënës të shqiptimit, intonacionit, diksionit dhe, përgjithësisht, të të folurit bukur të shqipes.

Fjala e folur në mjedise, të tilla si: skena e teatrit, filmi dhe radioja e televizioni duhet të jetë cilësisht e ndryshme nga fjala e zakonshme, nga të folurit e shkujdesur të njerëzve të thjeshtë.

Në çdo rast, një të folur i tillë, publik, ka nevojë të jetë jo vetëm mjet komunikimi, por edhe mjet i ndikimit estetik te dëgjuesit ose shkuesit. Kjo rrethanë bën të domosdoshme që fjala e aktorëve, e gazetarëve dhe paraqitësve të programeve artistike në radiotelevizion si dhe në mjedise të çfarëdoshme publike të jetë e përpunuar, e zgjedhur në përputhje me funksionin estetik ose artistik etj., por duhet që folësit (në këtë rast aktorët dhe gazetarët, paraqitësit e programeve etj.) të jenë edhe të përgatitur teknikisht për të folur me diksionin dhe me intonacionin e duhur.

1.1. **Anglishten dhe gjuhët e tjera do t'i mësojmë sa më mirë, por edhe shqipen ta mbrojmë e ta ruajmë.** Vitet shkojnë me shpejtësi, por hallet e shqetësimet e shqiptarëve nuk shterojnë. Midis tyre (dhe, ndoshta, për sherr të tyre), **ka shumë vjet që është lënë pas dore gjuha shqipe e shkruar dhe e folur.** Të gjithë janë të drithëruar e të dhënë me mish e me shpirt pas mësimit të gjuhëve të huaja, sidomos të anglishtes, dhe bëjnë mirë, por gati askush nuk shqetësohet për gjuhën shqipe, për kulturën e saj shkrimore në rënie dhe për nëpërkëmbjet e qëndrimin e pandërgjegjshëm të mediave të shkruara e të folura ndaj saj. Gjuhëtarë, përkthyes dhe arsimitarë dashamirë e mbrojtës të shqipes kanë shkruar e vijojnë të kritikojnë gabimet e qëndrimet dhunuese të shqipes, porse ato duket se bien në veshë të shurdhët. Përndryshe nuk ka se si shpjegohet që ditë për ditë, pa ua vënë veshin vërejtjeve dashamirëse që nuk kanë munguar, në gazetata e revistat shqiptare dalin gabime të rënda drejtshkrimore dhe ndërtime të mbrapshta e kundër normës gjuhësore të shqipes standarde, të atilla që edhe nxënësve të shkollës fillore nuk mund t'u falen. P.sh., në njoftimet e televizioneve për programet ose emisionet e reja, ka përbindshërira shkrimore dhe thyerje të rënda të normave më fillestare, më të thjeshta të drejtshkrimit të shqipes. Dikush shkruan **idea** (në vend të **ideja**), dikush shkruan **e diele, e djelë** (në vend të formës së drejtë **e diel**) dhe, për turp e dëm të madh, deri fjalë tashmë të stërpërdorshme, si: **tradhtar, tregtar, tregti** në botimet e sotme shkruhen gabim (tradhëtar, tregëtar, tregëti). Dikush shkruan **shkruajta**, dikush **shkruva**, dikush **shkrojta**, ndërsa forma normative **shkrova** gati po harrohet. Kam formuar bindjen se kjo ndodh jo vetëm nga padija, nga mosnjohja e normës, por më tepër nga pakujdesia, nga mospërfillja e rregullave dhe

normave të shqipes standarde, nga mbivlerësimi i së huajës dhe nga nënvlerësimi (ndoshta edhe përçmimi (!?)) i kulturës kombëtare në përgjithësi.

Gjithmonë, për fatin e keq të Shqipërisë e të shqiptarisë, nuk kanë munguar në mjediset tona edhe njerëz që përulën e rrëmbehen plotësisht nga e huaja, por edhe që guxojnë të përbuzin gjuhën shqipe e të ankohen për “varfërinë” e saj. Le të kujtojmë, me këtë rast, kritikën dhe ironinë e fortë therëse që pat shprehur në kohën e vet poeti Filip Shiroka në vjershën e tij “*Si po prishet gjuha shqipe*”, një nga krijimet e bukura e të famshme për kohën e vet, por edhe me vlerë aktuale për ditët tona. Edhe “*Apa*” i epikës shqiptare, poeti i madh Gjergj Fishta, duke i mëshuar po asaj ideje që shprehte Shiroka, lëvdon huret e bukurinë e shqipes dhe mallkon ata që flasin “*në gjuhë të huaj kur nuk është nevoja*” dhe lënë mbas dore shqipen, gjuhën e vet amtare.

*“...Pra, mallkue njai bir shqiptari,
që këtë gjuhë të Perëndisë,
trashigim si na e la i pari,
trashigim s’ia len fëmijës;
dhe atij ju thaftë po goja
që e përbuz këtë gjuhë hyjnore,
e në gjuhë të huej kur s’asht nevoja,
flet, e t’vetën len mbas dore.”*

1.2. Shkaku dhe pasojat e vërshimit të përshtuar të fjalëve të huaja sot

Periudha kalimtare e viteve 1991-2001 ose: nga socializmi real në demokraci, që, po ta kthejmë në terma sociolinguistikë, do të thotë: kalimi nga një vlerësim shumë i lartë për gjuhën dhe kulturën e saj në një liri të plotë e në një qëndrim gati hapët të pakujdesshëm ndaj gjuhës së njësuar dhe kulturës së gjuhës në përgjithësi.

Gjendja, siç e kemi shprehur edhe herë të tjera, është kjo: zell e vrull i lëvdueshëm për të mësuar sa më shpejt e sa më mirë gjuhët e huaja, sidomos anglishten dhe italishten, gjë që duhet të na gëzojë; kujdes shumë i pakët e, ndonjëherë, edhe shpërfillje e gjuhës shqipe dhe e normave të standardit, gjë që duhet të na shqetësojë. Diskutime e “qarje” prej krokodili për gjoja zgjidhjen

e pamirë të variantit letrar mbi bazën e toskërishtes, shpesh, madje, edhe për të mbuluar paaftësinë dhe pamjaftueshmërinë e përgatitjes mirëfilli gjuhësore që kërkon sot koha për ata që shkruajnë e flasin në publik.

Pasojat: vërshim i përshtuar dhe i pafrenueshëm i fjalëve të huaja të panevojshme, shtim i termave të huaj në vend të termave shqip që përdoren normalisht dhe nuk ka pse të mënjanohen. Kjo, qysh nga Kuvendi i Shqipërisë, të cilin, vetë ata që e përbëjnë (deputetët dhe drejtuesit e tij) në mbi 90 % të rasteve e quajnë "Parlament" dhe jo shqip, siç e ka emërtesën zyrtare. Së këndejmi edhe *kryeparlamentar* (në vend të kryetar i Kuvendit), **elektorale** në vend të **zgjedhore**, **elektorati** në vend të **zgjedhësit**, **lokale** në vend të **vendore** etj. Dua të theksoj se këto ditë, në shtypin dhe në mediat e folura të Kosovës, kam lexuar e dëgjuar me kënaqësi **kuvendar** e **kryekuvendar**, në vend të **parlamentar** dhe jam ndier i ngazëllyer e kam thënë me vete nga thellësia e shpirtit: U vaftë mbarë puna kuvendarëve dhe Kuvendit të Kosovës, si dhe gazetarëve të atjeshëm që, me gjithë problemet ende të mëdha politike e ekonomike me të cilat ndeshen, gjejnë rast e nge edhe për pastrim e kujdes ndaj gjuhës shqipe! Kjo përvojë mund dhe duhet të vihet në jetë edhe në praktikën tonë zyrtare, duke u dhënë hapësirë formimeve, të tilla si: *grupi kuvendor*, *mbledhja e Kuvendit*, *zgjedhjet vendore*, *fushata zgjedhore* etj.

Kanë hyrë e nuk pushojnë së hyri edhe jo pak mënyra të thëni apo ndërtime sintaksore të papranueshme për shqipen, thjesht si ndikim nga gjuhët e huaja.

Politikanët dhe shtetarët janë ata që japin më së shumti shembullin e keq në përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme. Fill pas tyre vijnë gazetarët dhe analistët, të cilët, nganjëherë si pasojë e përsëritjes së papeshuar e të pamenduar të asaj që dëgjojnë a regjistrojnë nga bisedat apo shkrimet e politikanëve e shtetarëve, po më shumë edhe nga mendja e qëndrimi i tyre i pandërgjegjshëm, nga nguti e mosnjohja e shqipes dhe e fjalorit të saj, lëshojnë përbindshëria, siç është, ndër të tjera, i famshmi "komisioni bipartizan", në vend të "dypalësh, i dy partive, dy partiak a prej dy partish". Dhe, për ironi të madhe, kjo fjalë vijon të mbetet në përdorim si gram i keq që mbin në ara, pavarësisht nga kritikata e përsëritura që kemi bërë pikërisht për atë hibrid përbindshëror. Kështu, nga padija e pakujdesia e

disa prej atyre (qofshin politikanë apo gazetarë) që i lëshojnë për herë të parë nga goja, *fjalët dhe termat e huaj vijnë e bëhen si orteku që nuk e ndalon dot*. Shihni se si përhapen e përdoren pa pushim fjalë, të tilla si: *involvoj, involvim, implementoj, implementim, zona rurale, staf, bord, draft, prioritet, prioritar-e, konfrontoj e konfrontim, total-e, ekzil, moment, fluks, fokus, frustracion, promovoj e promovim, risk e riskoj, premioj, lider, lidershhip, investigoj, interferoj, interferim, prononcohem, prononcim, anonçoj, anonçim, akomodoj, akomodim, flash, maxhoranca, minoranca, gjeneratë, gjeneroj konflikte, primar-e, konsensus, konsensual-e, fans-i, menaxher, menaxherial, menaxhoj, startoj, startim, donator, aks, top (sekret, model, kanal, radio etj.), petrol, posedoj, posedim, shoë, shoëmen, prosperitet, suvenir, biznes, biznesmen, muzikë live, koncert live, luku, benefic, editor, shopping, killer, serial killer, kuiz (pyetje), sharm (hir, bukuri fizike), aksesor (pjesë plotësuese), çikatriçe (oragë, shenjë e prerjes me thikë), destruktiv-e (shkatërrues-e) etj. Për të ditur kuptimin e tyre, siç shihet, do të duhej me doemos një fjalor anglisht-shqip dhe disa fjalorë të tjerë dygjuhësh italisht-shqip, frëngjisht-shqip etj.*

Huazimi i fjalëve të tilla, sidomos i anglicizmave (qoftë të marra nga anglishtja e BE-së, qoftë nga anglo-amerikanishtja) vijnë në shqipen në kuadrin e një *dygjuhësie të çalë*, d.m.th., nëpërmjet shqiptarëve që nuk e dinë mirë anglishten dhe nuk kanë as ndershmërinë dhe as përgjegjësinë më të vogël që, së paku, para se të flasin e të shkruajnë shqip ato që i kanë lexuar a dëgjuar në anglisht, t'i shohin se si përkthehen në fjalorët anglisht-shqip, të cilët tashti, fatmirësisht, nuk na mungojnë.

Kur dëgjon disa prej radiove private, si p.sh. "*Top-Albania Radio*", të duket se jemi të pushtuar nga ndonjë ushtri anglofone dhe shqipja nuk ngjan më si gjuha jonë, por si një përzierje a "*hibride*" e tipit të "*franglais*" (frënglishtes), kundër të cilës me aq zell e atdhetari luftojnë prej vitesh francezët. Edhe neve na kërcënon sot rreziku i një "*shqipanglitalishteje*", prandaj, po ritheksoj për të disatën herë atë që e kemi thënë edhe në një kumtesë të përbashkët me z. Edmond Tupja para disa kohësh: në qoftë se nuk duam që një shqipe e përçudnuar të përçudnojë edhe mendjen e shqiptarëve, duhet që shteti dhe krejt shoqëria e qytetëruar shqiptare të shkunden nga letargjia dhe të dalin nga mjegullnaja e kësaj shqipanglitalishteje që rrezikon të na kaplojë.

1.3. Rikthimi i fjalëve të huaja që ishin zëvendësuar me sukses me fjalët shqipe përkatëse.

Mendojmë se një dukuri e tillë përbën dëm të jashtëzakonshëm. Ja disa prej fjalëve të huaja të panevojshme, të cilat vite më parë kanë qenë mënjanuar me sukses nga fjalët shqipe përkatëse: eksperiencë (përvojë), ambient (mjedis), evitohet (shmang, mënjanohet), dedikohet (përkushtohet), presion (trysni), rekomandohet (këshillohet), ekspresiv (shprehës), ekspresivitet (shprehësi), iniciativë (nismë), kurioz-e (kureshtar-e), kuriozitet (kureshtje), distancë (largësi), distancoj (largoj), aktivitet (veprimtari), kontribut (ndihmesë), prezent-e (i pranishëm, e pranishme), elektoral-e (zgjedhor-e), lokal-e (vendor-e), kartë identiteti (letërnjoftim), persekutoj (përndjek), publikohet (botoj, popullarizohet), total-e (tërësor-e), totalisht (tërësisht, krejtësisht), komunikohet (kumtohet), komunikatë (kumtesë), likuidohet (shlyej, laj, asgjësoj), likuidim (shlyerje, larje, asgjësim), abuzohet (shpërdorohet), abuzim (shpërdorim), tentativë (orvatje, përpjekje), prezencë (prani), okazion (rast, rastësi), ofensivë (sulm, sulmim, mësymje), suprem (më i larti), nordik-e (verior-e), komunitet (bashkësi, ngulim), nacional-e (kombëtar-e), internacional-e (ndërkombëtar-e), direkt-e (i, e drejtpërdrejtë), deciziv-e (vendimtar-e), unik-e (i vetëm, e vetme), unifikohet (njësoj), unifikim (njësim, njëjtësim), komercial-e (tregtar-e), apel (thirrje), apeloj (bëj thirrje), precipitohet (ngutem, shpejtoj, nxitoj, përshpejtoj), prefekt-e (i e përsosur), statuetë (shtatore), asimilim (përvetëm, përvetësim), dekadë (dhjetëvjeçar, dhjetëditësh), demonstroi (shfaq), distributor (shpërndarës), fleksibël (i përthyeshëm, e përthyeshme), impresion (mbresë, përshtypje), impresionues-e (mbresëlënës-e, që të bën shumë përshtypje), inkuadroj (përfshij), kreativ-e (krijues-e), konstelacion (yllësi), koshient-e (i vetëdijshëm, e vetëdijshëm-e, i ndërgjegjshëm, e ndërgjegjshme), kredibilitet (besueshmëri), kualitet (cilësi), kuantitet (sasi), mentalitet (mendësi), ofendoj (fyej), ofezë (fyerje), ezauroj (shter, shteroj), origjinë (zanafillë), permanent-e (i përhershëm, e përhershme), mental-e (mendohet), reciprok-e (i ndërsjellë, i shoqishojmë), sentiment (ndjenjë), stabilitet (qëndrueshmëri), unanimitet (njëzëri, me një zë), vakant-e (bosh-

e, i zbrazët), legal-e (ligjësor, i ligjshëm, ligjor), angazhohem (zotohem), angazhim (zotim), aprovoj (miratoj, tumiroj), aprovim (miratim, tumirim), balancoj (baraspeshoj, barazoj), novitet (risi), sensibilitet (ndjeshmëri), aparençë (dukje, pamje e jashtme), monitoroj (vëzhgoj, vrojtoj), monitorim (vëzhgim, vrojtim), interlokutor (bashkëbisedues, bashkëfolës), evokoj (sjell në mend, rikujtoj), neutral-e (asnjanës-e), kontestoj (kundërshtoj, nuk pranoj), konfrontoj (ballafaqoj, ndesh, vë përballë, ndërsynoj), bilateral-e (dypalësh-e, i dyanshëm, e dyanshme), absorboj (përthith, thith), reflektohet (pasqyrohet), replikë (përgjigje, kundërpërgjigje), konstatoj (vërej, vë re), maksimal-e (më i larti, më e larta), minimal-e (më i ulëti, më e ulëta), rinovoj (përtërij), gratis (falas, pa pagesë), esencial-e (thelbësor-e), liçencë (leje, lejim), sensacional-e (i bujshëm, e bujshme), integroj (përfshij), tendencë (prirje) etj.

Shembuj të tillë tregojnë bindshëm se ka ardhur koha që dikush të përgjigjet, po edhe të paguajë për shkeljet kaq të rënda e të padurueshme të normave të gjuhës letrare zyrtare. Kemi përmendur pa ngurrim edhe instancat më të larta, kemi kritikuar më se një herë edhe paditurinë e mungesën e përgatitjes mirëfilli gjuhësore të shtetarëve dhe gazetarëve, duke cituar me të drejtë vlerësimin ironik të Faik Konicës për analfabetët me diplomë:

"Po sot shoh një turmë të errët prej analfabetësh me diplomë në xhep, që po i vërsulen shqipes dhe duan t' i vënë thikën në kurriz, që ta gdhendin pas formës që u pëlqen atyre; se të gjojnë kujtojnë që gjuha është një copë dru pa shpirt. Nuk dinë që është jo vetëm e gjallë, po dhe shumë e hollë, aq sa, po i shtrembërove pakëz një nyjë a një dell, trupi i tërë i tronditet, vuan dhe humb forcën bashkë me bukurinë".

Ky vlerësim fshikullues i Konicës së madh le të na vlejë për ta përmirësuar e vënë në udhë të mbarë punën për gjuhën shqipe. Pësimet e pamerituara të gjuhës shqipe në kohën tonë janë të tilla që, çdo gjuhëtari e dashamirësi të shqipes që ka ndonjë pikë gjak shqiptari, nuk mund të mos i vijë keq e të mos shprehë zemërim. Sidoqoftë, më tepër se çdo vërejtje a kritikë, në punën e gazetarëve dhe përgjithësisht të punonjësve të medias, të letrave e të skenës shqiptare, duhet të vlerësojmë rolin e tyre si përcues të fjalës shqipe, si përhapës të normave gjuhësore të sotme e të bukuri së gjuhës letrare kombëtare që me aq mundim e kemi prurë deri në

këtë shkallë. Sot, në mbarë botën e qytetëruar zotëron mendimi se **peshën kryesore në modelimin gjuhësor të masës e kanë mediat**, prandaj e ritheksojmë se *gazetarët janë edhe mësues të shqipes për masën e gjerë të lexuesve*. Bashkë me aktorët e skenës e të ekranit dhe shkrimtarët, armata jonë e gazetarëve shqiptarë ka në dorë më shumë se çdo mësues e pedagog (më tepër se universitetet a institutet e gjuhësisë) t'i prijë për së mbari kulturës së gjuhës shqipe. Kush mendon ndryshe, e ka gabim. Pushteti apo ndikimi i medias është aq i madh në jetën e në politikën e një vendi, por *ai është vendimtar edhe për mbarëvajtjen e pastrimit, pasurimit të fjalorit si dhe për mbrojtjen e gjuhës shqipe*. Le të marrim një shembull sa të thjeshtë, aq domethënës: shumëkush, pasi mbaron shkollën përkatëse, i dhënë pas punëve e detyrave të veta, rrallë e tek gjen kohë të lexojë ndonjë libër letrar. Shumica e njerëzve, për ditë e javë të tëra nuk lexojnë gjë tjetër përveç gazetave e ndonjë reviste. Dëgjojnë edhe radion e shohin emisione televizive. Çfarë do të thotë kjo për gjuhëtarin? Do të thotë se pjesa dërmuese e shqiptarëve, pas shkollës tetëvjeçare, për drejtshkrim, gramatikë e punë gjuhe mbështetet vetëm te shtypi dhe mediat e folura. Pra, përfundimi është i qartë dhe i thjeshtë. Po shëruam gjuhën e mediave, po të kemi gazetarë që shkruajnë drejt e folës që flasin e drejtshqiptojnë sipas natyrës së shqipes, atëherë do të kemi ndikim të mbarë te lexuesit e shikuesit. Shpresojmë se, krahas të tjerave, edhe përmirësimi i punës dhe i programeve mësimore të fakulteteve dhe degëve të gazetarisë në universitetet shqiptare do të japë frytet e veta të mira. Prej disa vjetësh, qysh kur u themelua dega e gazetarisë në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë është futur në planin mësimor të saj edhe kultura e shkrimit dhe e të folurit, si lëndë themelore që jep njohuritë bazë për kulturën e gjuhës dhe për normën e sotme. Të njëjtën gjë parakuptojnë edhe programet e planet mësimore të gazetarisë në universitete të tjera të vendit, si në Elbasan, në Universitetin privat UFO etj. Kultura e shkrimit si lëndë mësimore me program të rregullt e me kujdes për normën gjuhësore zhvillohet edhe në Fakultetin e Gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë. Shpresojmë që të ecet edhe më tej, duke i kushtuar kujdesin e duhur përgatitjes gjuhësore dhe kulturore të gazetarëve e punonjësve të medias, sepse vetëm kështu mund të shpresojmë të kemi vijimësinë dhe frytet e duhura në punën

gjuhëruajtëse e gjuhëpastruese.

1.4. Mbrojtja e gjuhës u përket, në radhë të parë, shtetit dhe institucioneve shtetërore e shoqërore që varen a lejohen prej tij.

Në çdo vend të qytetëruar ka ligje për mbrojtjen e gjuhës dhe shteti merr masat e nevojshme për studimin e mësimin e saj në shkolla si dhe për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar në të gjithë praktikën shkrimore e botuese zyrtare. Vetë sinonimi i gjuhës letrare të njësuar është cilësimi i saj si *standard* apo *zyrtare*. Në çdo vend me shtet ligjor ka një *politikë kulturore* në gji të së cilës "pjesa e luanit" duhet të jetë pikërisht kultura e gjuhës, ruajtja dhe pastrimi e pasurimi i pandërprerë, përpunimi, mësimi dhe studimi sa më i thelluar i saj. Mund të përmendim, p.sh., Francën, ku, për çdo fjalë a term të huaj të nevojshëm, vendoset me dekret shteti dhe bëhet një punë shumë e kujdesshme për pastërtinë e frëngjishtes. Revista "*Defence organisée de la langue française*" (Mbrojtja e organizuar e gjuhës frënge) vazhdimisht boton artikuj e studime "*contre le français*" (= kundër fjalëve të huaja nga anglishtja). Nuk duhet të mohohet se për shumë vjet radhazi edhe ndër ne nuk është bërë pak për gjuhën letrare shqipe, qoftë për studimin e përpunimin e saj, qoftë edhe për mësimin e saj në shkollë apo për zbatimin sa më të gjerë të gjuhës letrare nga institucionet shtetërore dhe kulturore. Janë botuar shumë studime e ndihmesa për pastrimin e pasurimin e gjuhës, botohen rregullisht edhe revista "*Gjuha jonë*" në Tiranë dhe "*Gjuha shqipe*" në Prishtinë, janë botuar edhe përmbledhje e libra me vërejtje kritike për gjuhën e shtypit e të mediave, si dhe një "*Fjalor për pastërtinë e gjuhës shqipe*" (Tiranë, 1998), mirëpo ata që duhet t'i këndojnë e t'i kenë përherë mbi tryezat e punës, as që duan t'ia dinë për to. Shkakut kryesor është se në këta vjetët e fundit kujdesi i shtetit dhe i institucioneve shqiptare për gjuhën ka rënë së tepërmi. Janë çelur edhe shumë sektorë pune joshitetorë, gjithçka është në udhën e privatizimit e të ndryshimeve. Kjo udhë do të vazhdojë, por një gjë duhet të mbetet përherë e "*paprivatizuar*". Ajo është *gjuha shqipe, gjuha jonë e përbashkët, që na dallon e na mban gjallë si komb më vete, si popull i lashtë e me kulturën e vet të vlefshme e të denjë për t'u mbajtur gjallë edhe më tej*. Për hir të kësaj bashkarie shpirtërore e kulturore themelore, që përfaqëson gjuha shqipe

për popullin shqiptar, sot më tepër se kurrë, pas ndryshimeve të bëra në Ballkan e, sidomos, pas luftës në Kosovë, që u mbyll me fitoren e NATO-s e me kthimin e kosovarëve në shtëpitë, po edhe në shkollat e institucionet e tyre arsimore, shkencore e kulturore, puna me gjuhën shqipe nuk mund t'u lihet vetëm shkollës dhe instituteve shkencore që e studiojnë.

Kishim shkruar e shprehur prej kohësh (e në raste të ndryshme) se edhe për gjuhën shqipe duhet të krijohet edhe një organizëm me karakter joshitetëror, por që të jetë i përhershëm e mbarëkombëtar dhe të ketë atributet e mbikëqyrjes e të drejtimit të gjithë punës për ruajtjen, vlerësimin, studimin dhe mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha hapësirat shqiptare. Siç është, p. sh., Këshilli i Lartë i Frankofonisë për gjuhën frënge, i cili e shtrin veprimtarinë e vet në Francë dhe në të gjitha hapësirat frëngjishtfolëse, si: në Zvicër, në pakicat frankofone të Italisë së Veriut etj. dhe në të gjitha vendet e tjera ku flitet e shkruhet gjuha frënge deri në Kanada. Më në fund, kjo dëshirë e kahershme e gjuhëtarëve, po besoj edhe e të gjithë dashamirëve të shqipes e të shqiptarisë, plotësohet me krijimin e “Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe”. Ky është një lajm shumë i gëzueshëm jo vetëm për gjuhëtarët, por edhe për arsimtarët, shkrimtarët, gazetarët dhe për të gjithë popullin shqiptar. Në atë këshill janë 17 gjuhëtarë të shquar nga Shqipëria, Kosova, hapësira shqiptare e Maqedonisë si dhe nga diaspora arbëreshe.

1.5. Shqipja standarde përballë procesit të globalizimit

Edhe në Shqipëri po ndihet ndikimi i globalizimit dhe kjo, në radhë të parë, shprehet me animin e fortë nga anglishtja, anim që të kujton pemët e larta që epohen e shkojnë andej nga fryn era; por procesi i globalizimit duhet kuptuar jo vetëm si arë e mbjellë që e zë breshri dhe bën kërdrinë mbi të, por edhe si përpjekje për ta ruajtur gjuhën nga asimilimi dhe për ta rreshtuar shqipen me dinjitet krahas gjuhëve të tjera evropiane. Ne, si popull, sikundër është theksuar edhe nga korifenjtë më të mëdhenj të albanologjisë, si: A. Buda, E. Çabej etj. jemi pjesë e familjes evropiane, por të jesh pjesë e kësaj familjeje të madhe evropiane nuk do të thotë harrim i vetvetes, nënshtrim ndaj ndonjë gjuhe tjetër, qoftë ajo edhe anglishtja, që shumëkush e quan sot “gjuha e botës”. Në

këtë bashkësi qytetërimesh ne duhet të futemi me identitetin tonë kulturor e kombëtar. Gjuha është pjesë themelore dhe shprehësja më e dukshme e këtij identiteti, tipari dallues më kryesor i mbijetesës sonë si komb.

Gjuha e globalizmit është anglishtja. Kjo bën që edhe në Shqipëri, po t'u referohemi disa fakteve me rëndësi, duhet të pranojmë se anglishtja po bëhet një gjuhë e dytë, në mos për të gjithë njerëzit, së paku për brezin e ri të qyteteve të mëdha e sidomos të qendrave me përqendrim të madh të institucioneve dhe marrëdhënieve me jashtë, siç janë sot, jo vetëm Tirana e Prishtina, si dy kryeqendrat me kah nga zmadhimi e metropolitanizimi, po edhe të tjera, si: Shkupi e Tetova, pjesërisht edhe Durrësi, Shkodra, Vlora etj. Po përmendim, ndër të tjera, rrethanën që në një qendër shqiptare si Tetova, sot ka edhe një universitet ku mësimet zhvillohen që të gjitha në gjuhën angleze dhe programet mësimore janë të njëjta me ato të Amerikës. Edhe në Tiranë ka disa vjet që është çelur Universiteti i Nju-Jorkut, ku, gjithashtu mësimet zhvillohen në anglisht dhe planet e programet e lëndëve janë të njëjta me ato të Amerikës. Ndërkaq, të dhënat tregojnë se ndikimi dhe anësimi nga anglishtja është edhe më i shtrirë:

Anglishtja sot mësohet që në moshën parashkollore, d.m.th., qysh në kopshtet e fëmijëve. Në jetën politike e shtetërore shumë "drafte" e ligje hartohen duke u bazuar te modele të huaja, të cilat janë të formuluar në anglisht. Vetë fjala "draft" në vend të *projekt*, "implementoj" në vend të *zbatoj*, vë në jetë, "rurale" në vend të *malore*, "aplikoj" në vend të *plotësoj*, *mbush* një formular etj. na flasin pikërisht për "erën" anglo-amerikane të të shkruarit.

Shumë organizata të huaja që veprojnë në vendin tonë dhe në Kosovë, operojnë në gjuhën angleze, p.sh.: OSBE, NATO, PNUD, KFOR etj.

Literatura që përdoret sot për çështje të ndryshme ndërkombëtare, po edhe të gati e të gjitha marrëdhënieve ndërshtetërore është në gjuhën angleze.

Anglishtja është gjuhë e dytë zyrtare në Kosovë.

Takimet e konferencat ndërkombëtare zhvillohen kryesisht në anglisht.

Është bërë si diçka e zakonshme që emrat e shumë shoqërive prodhuese e kompani biznesi të emërtohem në anglisht, p.sh.:

AMC (Albanian Mobile Communication)

NBG (National Bank of Greece)

Alb Telecom etj.

Në anglisht i kanë emrat shumë hotele, bare, klube, p.sh.:

Grand Hotel, Pradise Hotel, Tirana Internacional Hotel, Choco Bar, Flower Bar, London Club etj.

Shumë radio e televizione shqiptare i kanë emrat anglisht. Madje, edhe shqiptimi i fjalëve "radio" e "television" bëhet si në anglisht, p.sh.:

Top Channel, Vlora Channel, 24 News, Vizion +, Top Radio etj.

Shumë tituj gazetash e revistash janë në anglisht, p.sh.:

Gazeta "*Tirana Observer*", "*Albania*", "*Standard*", gazeta kosovare "*Express*" etj.

Shumë grupe këngëtarësh e muzikantësh i kanë emrat në anglisht. Madje, shpesh, edhe këngët janë në anglisht, p.sh.:

West Side Family, Big Mamma, Hana Band, The dreams etj.

Shumë reklama, postera e njoftime në gazeta i gjejmë në anglisht, p.sh.:

"Tirana Airport Partners SHPK is seeking for Traffic Manager on Duty who will report to Airport Service Director..."

"Western Union. Unë ju dërgoj ndihmë!"

Gjuha e kompjuterëve, e elektronikës është në anglisht.

Në gjuhën e politikës e të shtypit përdoren shumë fjalë anglisht. Shumë fjalë anglisht kanë hyrë në gjuhën e përditshme, p.sh.:

DJ, VIP (<Ver important person), **TASK FORCE, Hitet e javës, Muzikë House, Film horror, luk,-u** (*ndryshoj lukun, kujdesem për lukun, me një luk të ri*), **kurrikula** (<cv), **shou** (*top-shou, shoumen*) etj.

Siç shihet, edhe në gjuhën shqipe kemi vërshimin e shumë fjalëve anglisht duke përfshirë këtu edhe emrat e përveçëm. Këto hyjnë kryesisht nga gjuha e shkrimit, si: përkthimet politike, letrare, ekonomike, nga gazetatat, nga gjuha e folur e televizioneve, radiove, intervistave e konferencave të shtypit etj. Si pasojë, vihen re shmangie e shkelje gjuhësore në të gjitha rrafshet, p.sh.: në rrafshin e leksikut, të morfologjisë, të sintaksës e kryesisht të drejtshkrimit, ku drejtshkrimi (dhe drejtshqiptimi) i emrave të përveçëm të huaj duhet parë si një çështje më vete, që ka jo pak probleme e mëdyshje për t'u zgjidhur.

Ruajtja e grafisë së huaj po karakterizon vitet e fundit shkrimin e emrave të përveçëm të huaj të njerëzve e të vendeve, veçanërisht ata të përdorur rishtas, por edhe të tjerë me traditë përdorimi më të hershme në shqipen. Po vihet re një praktikë “e re”, e cila është në kundërvënie të plotë me parimin fonetik të të shkruarit. Disa e përpiqen ta përlligjin (justifikojnë) këtë praktikë me faktin se numri i këtyre emrave të huaj që po hyjnë në gjuhën shqipe është aq i madh, saqë është e vështirë që të mësosh shqiptimin e tyre dhe pastaj t’i shkruash ato duke zbatuar grafinë e gjuhës shqipe; aq më tepër sot kur përballemi me epokën e superzhvillimit të teknologjisë së informacionit, të kontakteve pa fund të gjuhëve e të kulturave, jo vetëm përmes shkrimit e botimeve, po edhe nëpërmjet postës elektronike, botimeve në faqet e internetit, si edhe përmes takimeve të drejtpërdrejta, si rezultat i lëvizjes së lirë të njerëzve, të ekspansionit të anglishtes dhe të shndërrimit të saj në “gjuhë globale”.